

Njoftim

Termat e Referencës (ToR)

Mentor për Zbatimin e Ciklit të Këshillimit Drejt Punësimit

Titulli i projektit	“Zgjerimi i shtrirjes dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit social të Qendrës Sociale Balashe për fëmijët dhe familjet në nevojë” (EMBRACE BALASHE)
Pozicioni	Mentor
Lloji i kontratës	Kontratë Shërbimi
Periudha kohore	Tetor 2025 – Mars 2026 (80 ditë pune)
Zona e zbatimit	Elbasan

Informacion i përgjithshëm mbi organizatën:

Themeluar në vitin 2011, Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA) është një OSHC rome e cila qëndron për një shoqëri multi-etnike dhe gjithëpërfshirëse që bazohet në parimet universale të të drejtave të njeriut dhe barazisë.

Misioni i organizatës është të mundësojë një zhvillim të barabartë dhe të qëndrueshëm të komuniteteve rome nëpërmjet avokimit, mobilizimit, fuqizimit, bashkëpunimit, hulumtimit të orientuar drejt politikave, veprimit dhe kërkimit pjesëmarrës, si dhe pjesëmarrjes së barabartë në proceset demokratike, akses të barabartë në të drejta dhe shërbime dhe promovim i kulturës dhe identitetit rom.

Informacion rreth projektit:

Projekti “Zgjerimi i shtrirjes dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit social të Qendrës Sociale Balashe për fëmijët dhe familjet në nevojë (EMBRACE BALASHE)” është duke u zbatuar nga Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri – IRCA në partneritet me Bashkinë e Elbasanit. Ky projekt zbatohet me mbështetjen e programit të Bashkimi Evropian për Kujdesin Social (EU4SocialCare) i financuar nga BE dhe i zbatuar nga UNICEF Albania dhe World Vision Albania.

Projekti do të mbështesë krijimin e protokollit të shërbimeve të integruara, si dhe planin operacional të Qendrës Sociale Balashe për ofrimin e shërbimeve të integruara (shërbime lëvizëse dhe në ambientet e qendrës), duke forcuar partneritetin me shërbime të tjera ekzistuese, për të siguruar mbështetje gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme për të gjithë anëtarët e komunitetit. Shërbimet përfshijnë: shërbime psikologjike dhe fizioterapeutike, mbështetje pas shkolle për fëmijët, si dhe lehtësim për zhvillimin e aftësive dhe punësimit.

Një ndër komponentët kyç të projektit është këshillimi drejt punësimit, përmes një qasjeje të strukturuar që ndihmon përfituesit të kuptojnë potencialet e tyre, të përmirësojnë aftësitë e kërkimit të punës dhe të ndërmarrin hapa konkretë drejt integrimit në tregun e punës.

Qëllimi i shërbimit:

Mentori për zbatimin e ciklit të këshillimit drejt punësimit do të angazhohet në ndërtimin dhe zbatimin e një procesi këshillimi të individualizuar dhe në grup, për të ndihmuar personat e papunë (në ndihmë ekonomike) të përmirësojnë aftësitë e tyre personale, profesionale dhe të zhvillojnë një plan realist për punësim. Mentori do të ketë për detyrë të zbatojë në kohë dhe me cilësi aktivitetet e projektit në Bashkinë Elbasan si më poshtë:

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mentori, në bashkëpunim të ngushtë me stafin e projektit EMBRACE BALASHE, Sektorin e Ndihmës Ekonomike në Bashkinë Elbasan dhe Zyrën Vendore të Punësimit, do të angazhohet në procesin e identifikimit dhe përzgjedhjes së përfituesve potencialë për programin e këshillimit drejt punësimit (15 persona).
- Realizimin e një vlerësimi fillestar individual për çdo pjesëmarrës (profil profesional, arsim, eksperiencë, motivim, barriera për punësim).
- Hartimin dhe zbatimin e një cikli këshillimi drejt punësimit, i strukturuar në sesione javore motivimi për zhvillimin e aftësive të buta (soft skills), si: komunikimi, puna në grup, menaxhimi i kohës, etj.
- Të bashkëpunojë ngushtë me stafin e Qendrës Balashe dhe me strukturat e Bashkisë Elbasan për integrimin e pjesëmarrësve në programet e formimit profesional, e nxitjes së punësimit.
- Identifikimin e bizneseve lokale që janë të interesuara për të punësuar staf të ri apo për të ofruar pozicione praktike.
- Të monitorojë progresin dhe të përgatisë raporte mujore për ecurinë e procesit të trajnimit.
- Të kontribuojë në përgatitjen e dokumentacionit dhe evidencave për çdo aktivitet të zhvilluar.

Përveç këtyre, mësuesi është përgjegjës për dokumentimin e saktë të shërbimeve të ofruara në përputhje me procedurat financiare dhe administrative të projektit dhe për respektimin e standardeve profesionale dhe etike në punën e tij.

Kualifikimet dhe eksperiencia:

Kandidati ideal duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Diplomë universitare në Shkencat Sociale, Edukim, Psikologji, ose fusha të ngjashme.
- Minimumi 3 vite përvojë pune në pozicione të ngjashme me mentorim, trajnim apo punë me komunitetin.
- Eksperiencë me grupe në nevojë, veçanërisht persona të papunë dhe përfitues nga ndihma ekonomike.
- Njohuri të tregut të punës, programeve të punësimit dhe ndërmjetësimit në punë.
- Aftësi të shkëlqyera ndërpersonale dhe komunikimi.
- Aftësi për të ndërtuar raporte besimi dhe motivimi me pjesëmarrësit.
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të menaxhuar kohën dhe detyrat në mënyrë efikase.

Procedura e aplikimit:

Personat e interesuar duhet të dergojnë brenda **dates 10 Tetor 2025** në adresën e emailit institute.irca@gmail.com ose me postë në adresën: Rruga: Kristaq Prifti, Building 9, H2, D/A, Yzberisht, Tirane, 1052, Albania

dokumentat si më poshtë:

- një kopje të jetëshkrimit profesional (CV)
- një letër interesi

Vemendje:

Në subject të e-mailit të vendoset: Aplikim për pozicionin mentor në kuadër të projektit EMBRACE Balashe.

Kriteret e përzgjedhjes:

- Plotësimi i kushteve të thirrjes
- Cilësia e dokumenteve të dorëzuara

Vetëm kandidatët që ftohen për intervistë do të njoftohen për vendimin e përzgjedhjes. Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri – IRCA rezervon të drejtën të mos informojë kandidatët e refuzuar për arsyet e refuzimit të tyre.

Të gjithë personat që punojnë me programet e IRCA janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të IRCA, kodin e sjelljes si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni.